LIGJ
Nr.7673, datë 17.2.1993

PËR KONTRATAT KOLEKTIVE TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj zbatohet për të gjithë personat e punësuar në sektorin shtetëror ose privat nga punëdhënës shqiptarë a të huaj.

Neni 2

Kontrata kolektive është një marrëveshje ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve që rregullon marrëdhëniet juridike të punës dhe të drejtat e detyrat e secilës palë që burojnë nga këto marrëdhënie.

Neni 3

Kontrata kolektive rregullon:
1. Kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës që lindin në bazë të kësaj kontrate.
2. Të drejtat dhe detyrat e ndërsjellta të palëve që burojnë nga marrëdhëniet e punës.
3. Kushtin disiplinor për rastet e parashikuara në nenin 20 të këtij ligji.

Neni 4

Kontrata kolektive nuk mund të parashikojë për palët të drejta dhe detyrime që janë në kundërshtim me ligjet.

Kontratat janë të pavlefshme për pjesët e tyre që bien në kundërshtim me ligjet.

II. LIDHJA E KONTRATËS KOLEKTIVE

Neni 5

Kontratat kolektive të punës lidhen, sipas kushteve të parashikuara në këtë ligj, në nivel ndërmarrjeje dhe dege ekonomike.

Kontrata kolektive është e detyrueshme të lidhet ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve në të dy nivelet.

Neni 6

Kontrata kolektive e punës në nivel ndërmarrjeje lidhet ndërmjet organit drejtues të punëdhënësit dhe komisionit përfaqësues të punëmarrësve, numri i anëtarëve të së cilit të mos jetë më i madh se 7.

Në ndërmarrjet ku nuk ka organizata sindikale dhe në ato ku punëmarrësit nuk janë anëtarë të së njëjtës sindikatë, për lidhjen e kontratës kolektive, përfaqësuesit e punëmarrësve zgjidhen me votim

prej tyre.

Numri i përfaqësuesve të çdo sindikate është në përpjestim me numrin e anëtarëve të secilës prej tyre.

Neni 7

Kontrata kolektive e punës në nivel dege lidhet ndërmjet organit përfaqësues të punëdhënësve dhe komisionit përfaqësues të punëmarrësve, numri i anëtarëve të së cilit të mos jetë më i madh se 7. Për lidhjen e kontratës kolektive në këtë nivel, përfaqësues të punëdhënësve janë organet drejtuese të korporatave, shoqatat e punëdhënësve privatë dhe për sektorin buxhetor ministritë përkatëse.

Kur punëmarrësit nuk janë anëtarë të së njëjtës sindikatë, për lidhjen e kontratës kolektive, përfaqësuesit e punëmarrësve zgjidhen nga rradhët e organeve drejtuese të sindikatave, me votim prej tyre.

Numri i përfaqësuesve të çdo organi drejtues është në përpjestim me numrin e anëtarëve.

Neni 8

Për kushtet themelore kontrata kolektive e punës në nivel ndërmarrjeje nuk duhet të përmbajë për punëmarrësit kushte më pak të favorshme se ato të parashikuara në kontratën kolektive në nivel dege.

Neni 9

Kontrata kolektive lidhet për një kohë të caktuar ose për një kohë të pacaktuar. Kontrata kolektive e lidhur për më tepër se një vit quhet kontratë me një kohë të pacaktuar.

Me përfundimin e afatit të parashikuar në kontratat kolektive, palët mund ta zgjatin më tej afatin në marrëveshje ndërmjet tyre, duke ruajtur kushtet ekzistuese të kontratës, ose duke parashikuar kushte të reja.

Neni 10

Kontratat kolektive lidhen brenda tremujorit të parë të çdo viti financiar. Për subjektet e reja ato lidhen brenda 3 muajve nga data e krijimit. Ndërsa për kontratat me afat më shumë se një vit, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afatit të kontratës së mëparshme.

III. PROCEDURA E LIDHJES SË KONTRATËS KOLEKTIVE

Neni 11

Përfaqësuesit e punëdhënësve dhe të punëmarrësve kanë të drejtë e detyrë të zhvillojnë bisedime paraprake për lidhjen e kontratës kolektive.

Neni 12

Pala që do të ushtrojë të drejtën për të hyrë në bisedime paraprake, njofton me shkrim palën tjetër për vendin e datën ku do të kryhen bisedimet, si dhe për çështjet që trajtohen në projektin e kontratës kolektive të hartuar prej saj.

Pala tjetër duhet të bjerë dakord për zhvillimin e bisedimeve dhe caktimin e përfaqësuesve të saj brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit.

Neni 13

Bisedimet paraprake duhet të dokumentohen në një procesverbal që nënshkruhet nga përfaqësuesit e të dyja palëve.

Neni 14

Pas përfundimit të bisedimeve hartohet teksti përfundimtar i kontratës kolektive, i cili nënshkruhet nga përfaqësuesit e secilës palë.

Neni 15

Kontrata kolektive përmban emrat e organeve drejtuese të palëve kontraktuese dhe përfaqësuesve të tyre, datën e nënshkrimit dhe fushën e zbatimit të saj.

Neni 16

Kontrata kolektive e nënshkruar prej palëve duhet të depozitohet e regjistrohet nga punëdhënësi brenda 5 ditëve nga data e nënshkrimit:

a) në zyrën e punës për kontratat që lidhen në nivel ndërmarrjeje;

b) në drejtorinë e Lidhjeve Profesionale pranë Ministrisë së Punës, të Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë për kontratat që lidhen në nivel dege.

Kontrata kolektive e punës hyn në fuqi nga data e regjistrimit të saj.

Neni 17

Nëse palët nuk bien dakord për kushtet themelore të kontratës së ardhshme kolektive, atëherë ato duhet të kërkojnë një ndërmjetës për gjetjen e kompromisit.

- Lista e ndërmjetësve të autorizuar do të shpallet nga Ministria e Punës.

- Nëse palët nuk bien dakord për zgjedhjen e ndërmjetësit, atëherë palët duhet t'i kërkojnë ministrit të Punës të caktojë një ndërmjetës.

- Nëse ndërmjetësi nuk gjen zgjidhjen e kompromisit brenda 15 ditëve nga data që iu paraqit kërkesa me shkrim për ndërmjetësim, atëherë palët mund:

a) të bien dakord për të caktuar një arbitër ose

b) të bëjnë grevë në përputhje me ligjin.

Neni 17/a

Palët mund të zgjedhin një arbitër, nga lista e arbitrave të miratuar nga ministri i Punës.

Arbitri duhet të vendosë brenda 30 ditëve nga data që ai ka marrë kërkesën me shkrim, nga palët për arbitrim.

Vendimi i arbitrit është i detyrueshëm për të dy palët dhe duhet të përfshihet në kontratën e ardhshme kolektive.

Pas këtij vendimi nuk mund të bëhet grevë për kushtet e kontratës.

Nëse vendimi bie në kundërshtim me ligjet ose nëse arbitri është haptazi i njëanshëm, palët mund të ankohen në gjykatë, e cila shqyrton ligjshmërinë e vendimit të arbitrit dhe nuk shqyrton çështjen me themel.

Ankimi kundër vendimeve të arbitrit për konfliktet në nivel dege bëhet në gjykatën e Tiranës, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Ankimi kundër vendimeve të arbitrit për konflikte në nivel ndërmarrje bëhet në gjykatën e apelit, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Neni 17/b

Këshilli i Ministrave përcakton rregullat konkrete për ndërmjetësimin, arbitrimin dhe procedurën e ankimit kundër vendimeve të arbitrit.

IV. EKZEKUTIMI, NDRYSHIMI DHE PËRFUNDIMI I KONTRATËS KOLEKTIVE TË PUNËS

Neni 18

Palët kontraktuese duhet të zbatojnë me përpikmëri kushtet e kontratës kolektive.

Neni 19

Në rast se njëra nga palët nuk plotëson tërësisht ose pjesërisht kushtet e kontratës, pala tjetër ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 15 ditëve nga data që konstaton se pala tjetër nuk plotëson kushtet e kontratës kolektive.

Neni 20

Për mospërmbushjen e plotë ose të pjesshme të detyrimeve që burojnë nga kontrata kolektive, palët detyrohen t'i paguajnë njëra-tjetrës si kusht disiplinor një shumë të hollash në masën e caktuar në kontratën kolektive të lidhur ndërmjet tyre.

Neni 21

Gjatë kohës së zbatimit të kontratës kolektive palët kontraktuese mund t'i bëjnë asaj ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në marrëveshje ndërmjet tyre.

Ndryshimet dhe plotësimet që i bëhen kontratës kolektive, duhet të pasqyrohen me shkrim në një dokument, i cili nënshkruhet nga të dyja palët. Ky dokument depozitohet dhe regjistrohet nga punëdhënësi, brenda 5 ditëve nga dita e nënshkrimit, pranë organit ku është bërë regjistrimi dhe depozitimi i kontratës kolektive.

Ndryshimet dhe plotësimet e kontratës hyjnë në fuqi nga data e regjistrimit të tyre.

Neni 22

Palët kontraktuese kanë të drejtë të vendosin përfundimin ose pezullimin e zbatimit të kontratës kolektive në marrëveshje ndërmjet tyre.

Kontrata kolektive nuk mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme.

Neni 23

Kontrata kolektive përfundon:

a) me kalimin e afatit të përcaktuar në kontratën kolektive, në rast se palët nuk vendosin zgjatjen e këtij afati në marrëveshje ndërmjet tyre.

b) në datën e falimentimit ose shpërndarjes së njërës nga palët.

Neni 24

Përfundimi i kontratës kolektive të punës duhet të regjistrohet nga punëdhënësi brenda 5 ditëve pranë organit, në të cilin është bërë regjistrimi dhe depozitimi i kontratës.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25

Rregullat konkrete për kushtet themelore të kontratës kolektive të punës përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 26

Nenet 15-22 të ligjit nr.7526, datë 3.12.1991 "Për marrëdhëniet e punës" si dhe çdo dispozitë

tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.489, datë 16.3.1993 të Presidentit të Republkës së Shqipërisë, Sali Berisha.